



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republike of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), nenit 32 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, në seancën e mbajtur me dt.28.04.2022 Kuvendi i Komunës pas shqyrtimit dhe votimit paraparak merr:

V E N D I M
PËR RRËNIMIN E OBJEKTIT

- I.** PËR RRËNIMIN E OBJEKTIT (shtëpia-ndërtesë) e cila është e evidentuar në parcelën kadastrale P-7060406-01048-2 ZK Brodosanë, pronë e komunës së Dragashit me sipërfaqe 105m/2, në vendin e quajtur "BRODOSANË-STACIONI" i cili është në gjendje të vështirë dhe i cili do të shfrytëzohet për nevoja komunale-ndërtimi i parkut publik.
- II.** Në bazë të këtij Vendimi, kryetari i Komunës, do të inicon procedurat e mëtejme për rrënimin e objektit dhe procedurat e ridestinimit të pronës komunale.
- III.** Për zbatimin e këtij vendimi përkujdesen: kryetari i Komunës, Drejtorati për Inspektion dhe organi kompetent për evidentimin e regjistrimit të pronës.
- IV.** Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

Shtojcë: Pjesë përbërese e këtij vendimi janë:

- a) Çertifikata e njësisë kadastrale 06 nr.952-206/22 e dt. 06.04.2022,
- b) Kopja e planit e njësisë P-70604006-01048-2,
- c) Peticioni i banorëve të fshatit Brodosanë.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
01Nr. 060/01-2575-2/22
Dt. 28.04.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Uran Halimi